

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Në
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919818/video-deklarata-e-rames-buzhala-a-ka-marre-lek-a-nu-k-ka-marre-lek-kete-e-vendos-dikush-tjeter/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 20:22:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 20:18:36 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0630fd2ff5c026e37395b3072659a84a454ea75d0379c9ea23819ed526b65560
TEKSTI	cbb5b4a40aa77bbf8266ef3a3c07a8e5d0c96eb73391cd01026516d60c0c0ca7
PAMJA	5eaaa58b5c486228af6e6de6bdc56ebf143ebef778dded06a2ff43913b1a08eb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	36caf8d839d08256bdeff2f831e198dee341a61f726a73a1acc90bf7c1fa05e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	6a4afcd2fdba1fd2c3f5e26c1cb3946785567999c2c435268418bbbef9bbb6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/36caf8d839d08256bdeff2f831e198dee341a61f726a73a1acc90bf7c1fa05e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



ÇIM PEKA

'Nuk e dija, nuk mjafton më'




FATMIR MEDIU


Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk iu kundërvu Vuçiqit dhe zgjodhi të flasë për Diellën

LAJMI I FUNDIT

ÇIM PEKA LIVE/ Këshilli i Sigurisë te Kodra e Kuajve



më të lexuarat



'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s' menaxhon dot më



'Asnjë hap pas'/ Dita e 120-të e protestave, pankartat: Edi, po të vjen fundi me ndëshkim!



'Rama padrino i Tahirit, Veliajt, Ballukut, Gysit, Vlorës'/ Bushati: Funksionimi i shtetit si bandë mafioze




Skandali i SHISH/ Muçollari: Rama do që krimi të mos merret vesh, jo që të mos ndodhë



Epitafi i frikës, apo frika e epitafit?



Berisha: Vlora Hyseni është kthyer për t'u dhënë restin bashkëpunëtorëve të vet që e tradhtuan



VIDEO-Deklarata e Ramës/ Buzhala: A ka marrë lek a nuk ka marrë lek, këtë e vendos dikush tjetër

22:18, 28/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Gazetari Berat Buzhala, i ftuar në emisionin 'Çim Peka LIVE' në SYRI TV, ka komentuar deklaratën e fundit të kryeministrit Edi Rama lidhur me akuzat dhe hetimet që kanë prekur njerëz të afërt me qeverinë.

Buzhala e cilësoi Ramën si një menaxher jashtëzakonisht të dobët në përzgjedhjen e njerëzve me të cilët ka punuar për një periudhë të gjatë, ndërsa tha se zhvillimet e fundit po sjellin një situatë ku emrat e njerëzve pranë kryeministrit po bien njëri pas tjetrit.

Sipas gazetarit, pyetja kryesore tashmë është se çfarë do të ndodhë me Ramën nëse hetimet dhe arrestimet vijnë të prekin njerëzit që kanë qenë pjesë e hierarkisë së tij qeverisëse.

Buzhala u ndal edhe te deklarata e Ramës, i cili ka mohuar të ketë marrë para, duke thënë se nëse dikush ka marrë ose jo, këtë duhet ta përcaktojnë institucionet.

'Minimumi që mundem me thënë për Ramën, është treguar menaxher jashtëzakonisht i dobët në përzgjedhjen e njerëzve me të cilët ka punuar, dhe ka punuar një kohë të gjatë. Po. Çështja për mua është gjithashtu jashtëzakonisht interesante.

A do të ketë fuqi Rama që kur këta punëtorë të tij në një hierarki, do të arrestohen disa, janë arrestuar, disa pritë me u arrestu, ku do të dalë emri i Ramës aty pastaj? Pra, se po i bien nga një, nga një Ramës, po i bien. A është gjë e mirë kjo?

Unë mendoj që është jashtëzakonisht e mirë. Pra, Rama aty ku dalloj unë me ju është... duket si me thënë, hermafrodite, që edhe me kontrollu edhe me u hidhëru. Domethënë, sepse Rama këtë konferencë për shtyp unë besoj se ai e thirri, nëse s'gabohem, 24 orë më herët.

Kur Rama ishte pak i nxehtur kur e thirri... kur e ka thirrur këtë gjënë. Pastaj doli aty edhe tha, 'Nuk kam marrë lekë. A ke marrë lekë a s'ke marrë lekë, vendos dikush tjetër'. Sepse një të gjithë... edhe Gysi thotë s'kam marrë lekë.

Sepse edhe ai taksisti që më solli tha, 'Gysi tha, kurrë s'ka punuar në shtet.' Domethënë, s'ka ndonjë përgjegjësi Gysi. Edhe Belinda e ka një rrëfim të vetin, edhe ai tjetri e ka një rrëfim të vetin. Çështja është, për mua është tepër e rëndësishme që këta njerëz po ikin, po bien.

A i lëshoi Rama, a s'i lëshoi Rama, është çështje tjetër. A po e do njerin më pak, tjetrin më shumë, gjithashtu është çështje tjetër. Po që po bëjnë mirë, që po shkërmoqet kjo perandori...

Nuk e di, nëse ti po mendon që SPAK-u s'i rreh... është argument, unë besoj nëse ka fituar veç një çmim, patjetër t'ia bëjmë hallall... me të hallallit e ka.

Nuk e di a ka fituar Rama. Unë bëra një analizë. Unë po them që ka qenë menaxher jashtëzakonisht i dobët, me njerëzit që ka punuar sepse këta po shihet, rrethi i tij.

Do të duhej të kishte ministra më të mirë. Sesa këta që i kanë ngrënë kumbullat prapa shpinës. Tashi na nuk domethënë që po pajtohem të gjithë me këtë gjë.

Domethënë përgjegjësia e Ramës, prapë po e përsëris, ana është penale', u shpreh ndër të tjera Berat Buzhala në SYRI TV.

© SYRI.net

Lexo edhe:



'Zyra e Agasit si 'Mekë' e pushtetit', Vangjeli: Aty parakaluan politikanë e gjyqtarë të Kushtetueses



Mbyllet protesta e 121-të, protestuesit: Nuk do të ndalemi



Arrestimi i Vlora Hysenit/ Ish-ministri i Ramës: Vartësit imitojnë shefin e tyre, e sillen si ai

Berisha: Foltoret e Ripërtëritjes në Vlorë dhe Elbasan dëshmuar se orteku i opozitës po rritet çdo ditë

VIDEO/ Shkullaku: Rama e nisi me krimin dhe po e mbyll me të, shqiptarët kanë të drejtë të reagojnë

Arrestimi i Vlora Hysenit/ Ish-ministri i Ramës: Vartësit imitojnë shefin e tyre, e sillen si ai

TË NGJASHME



'Rama padrino i Tahirrit, Veliajt, Ballukut, Gysit, Vlorës'/ Bushati: Funksionimi i shtetit si bandë mafioze



'O me Ramën, o me shqiptarët', aktivisti: Shoqëria civile, akademikët dhe kleri të mos heshtin!



Rama zhduket nga VIDEO zyrtare e OKB-së/ Zhupa: Foto e kryeministrit nuk shfaqet mes liderëve



VIDEO/ Thirrja në protestë: Në 5 tetor studentët ngrihen në protestë kundër Edi Ramës dhe qeverisjes së tij



'Rama në burg'/ Protestuesit nisin marshimin pas fjalimeve në protestën e 121-të



VIDEO/ Bajaziti: Rama e ka shndërruar komunikimin publik në qesharak, kërkon nga Europa të mos e lërë në baltë



FOTO/ Pankartat: Këshilli i Sigurisë, shumë karrige, shumë fjalë, po përgjegjësia ku ka për të dalë?

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do të gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.